

Në bazë të nenit 55 paragrafi 1 të Ligjit për organizim dhe punë të organeve të administratës shtetërore (“Gazeta zyrtare e RM” nr.58/00 dhe 44/02) dhe neni 24 dhe 26 të ligjit për arsim të mesëm (“Gazeta zyrtare e RM” nr.44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/02, 40/03, 42/03, 63/04, 82/04, 55/05, 81/05, 113/05, 35/ 06, 70/06 dhe 51/07), ministri i arsimit dhe shkencës miratoi program mësimor në lëndën fakultative hulumtimi i vendlindjes për klasën e VI të arsimit fillor tetëvjeçar, përkatësisht për klasën e VII, VIII ose IX për arsimin fillor nëntëvjeçar.

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
ENTI PËR ZHVILLIMIN E ARSIMIT

PROGRAMI MËSIMOR

HULUMTIMI I VENDLINDJES

LËNDË FAKULTATIVE

ARSIMI FILLOR

1. HYRJE

Lëndën mësimore *hulumtimi i vendlindjes* nxënësit mund ta zgjedhin në periudhën e tretë të arsimit fillor nëntëvjeçar (në klasën të VII, të VIII ose të IX). Qëllimi i futjes të kësaj lënde mësimore është që nxënësi të njihet me karakteristikat e vendlindjes nga aspekte të ndryshme: trashëgimia kulturore historike, pasuritë natyrore dhe raretetet, shenjat dalluese të ekonomisë, veçoritë dhe mundësitë e turizmit, vendet dhe objektet për rekreacion dhe pushim, ngjarjet autentike dhe kulturore, si dhe të zhvilloj bashkëpunim me bashkësinë lokale dhe mediat lokale. Mësimi i kësaj lënde mësimore kontribuon për krijimin e përshtypjes komplekse dhe të lidhur për karakteristikat e vendlindjes, për jetën në të dhe për zhvillimin e tij të qëndrueshëm.

Programi mësimor i hulumtimit të vendlindjes paraqet tërësi eksperte e cila gradualisht e fut nxënësin në procesin e hulumtimit shkollor që i lidhur me programet mësimore dhe karakter të detyrueshëm. Me aktivitetet për hulumtimin e vendlindjes, nxënësi duhet marrë njohuri aftësi që do të mund t'i zbatoj në jetën e përditshme.

Të gjitha pjesët e programit mësimor të hulumtimit të vendlindjes janë të strukturuar si aktivitete hulumtuese. Programi mësimor përmban gjashtë tema kryesore për hulumtim, ndërsa në kuadër të secilës prej tyre janë dhënë disa propozime për tema dhe përmbajtje të reja për projekte hulumtuese, për zgjedhjen e të cilëve vendosin nxënësit dhe mësuesi. Hulumtimi duhet të kryhet në shkollë ose në terren.

Lënda mësimore hulumtimi i vendlindjes realizohet me dy orë në javë, përkatësisht 72 orë në vit.

SHËNIM:

Në pajtim me dinamikën për futjen e edukimit dhe arsimit fillor nëntëvjeçar programi mësimor për nxënësit e klasës të VI të arsimit fillor tetëvjeçar të vitit shkollor 2008/09 është ekuivalent me programin mësimor për klasën e VII, të VIII ose të IX të arsimit fillor nëntëvjeçar.

2. SYNIMET E MËSIMIT PËR KLASËN E VII, VIII OSE TË IX

Nxënësi/ nxënësj:

- që nxënësi të njihet me karakteristikat e vendlindjes nga aspekte të ndryshme: trashëgimia kulturore historike, pasuritë natyrore dhe rarishtet, shenjat dalluese të ekonomisë, veçoritë dhe mundësitë e turizmit, vendet dhe objektet për rekreacion dhe pushim, ngjarjet autentike dhe kulturore, si dhe të zhvilloj bashkëpunim me bashkësinë lokale dhe mediat lokale.
- t'i zbuloj kushtet për jetë dhe ekzistencë të njerëzve në vendlindje;
- të aftësohet për identifikimin e problemeve në bashkësinë lokale dhe të nxitet të marr pjesë në zgjedhjen e tyre;
- të njihet me rreziqet e kanosjes të trashëgimisë kulturore-historike, pasuritë dhe rarishtet natyrore në vendlindje dhe të marr pjesë në mbrojtjen e tyre;
- të zhvilloj interes për pjesëmarrje në aktivitetet e bashkësisë lokale;
- të nxitet të marr pjesë në aksione në mjedisin lokal;
- të aftësohet të përdor burime të ndryshme njohurish;
- të aftësohet të marr pjesë në hulumtime të lidhura me vendlindjen (të aftësohet të zbatoj metodologji hulumtuese: të evidentoj dhe të paraqes të dhëna, të përgatis dhe të propozoj plan për realizimin e aktiviteteve/hulumtimeve dhe të lexoj dhe shpjegoj të dhëna nga tabelë, grafik, skemë, si dhe të përmbyll dhe prezantoj rrëfim)

3. SYNIME KONKRETE

TEMA 1: TRASHËGIMIA KULTURORE-HISTORIKE E VENDLINDJES (20 orë)			
synime	përmbajtje	terma	Aktivitete dhe metoda
<p>Nxënësi/nxënësjja:</p> <p>-t'i dalloj dhe t'i shpjegoj termat: objekt antik, objekt fetar, përmendore,, veçori etnologjike, shtëpi karakteristike në vendlindjen time;</p> <p>-të aftësohet ta përshkruaj vendndodhjen dhe veçoritë e lokaliteteve në vendlindje;</p> <p>-ta përshkruaj konstruksionin dhe materialin e objektit;</p> <p>-ta kuptoj rëndësinë e lokalitetit për bashkësinë lokale.</p>	<p>Veçori dhe njohuri të trashëgimisë kulturore-historike të vendlindjes</p> <p>Propozim-projekte:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Hulumtimi i një objekti antik në vendlindje 2. Hulumtimi i një objekti fetar në rrethinat afër 3. Hulumtimi i një përmendore në rrethinat afër 4. Hulumtimi i veçorive etnologjike të vendlindjes (kostume popullore, zakone) 5. Hulumtimi i ndërtimit dhe organizimit të jetës në shtëpi në vendlindje 6. Projekt tjetër sipas dëshirës të nxënësve 	<p>Objekt antik</p> <p>Objekt fetar</p> <p>Përme ndore</p> <p>Veçori etnologjike</p> <p>Shtëpi karakteristike</p>	<p>Hulumtimi i një objekti kulturor-historik në vendlindje: gërmim arkeologjik, objekt antik, objekt fetar, përmendore, veçori etnologjike, shtëpi karakteristike.</p> <p>Aktivitete:</p> <p>-përcaktimi i emrit të projektit dhe formulimi i synimeve të hulumtimit;</p> <p>-përpilimi i planit të hulumtimit (qëllime, detyra, afate);</p> <p>-përcaktimi i vendit të hulumtimit (zgjedhja e lokaliteteve), i mënyrave të evidentimit të të dhënave me shenja me të cilat do të shënohen objektet si dhe gjendja e tyre, në hartë dhe/ose tabelë të përgatitur që më parë.</p> <p>-punë në terren – evidentimi i lokalitetit dhe objektet në rrethinat pranë;</p> <p>-bisedë me njerëz: banorë dhe ekspertë për objektin/ lokalitetin ku hulumtohet;</p> <p>-skicimi (vizatimi) i lokalitetit dhe objektit ose fotografimi;</p> <p>-shënimi i të dhënave në tabelë, ndjekja e tyre dhe analiza e rezultateve;</p> <p>-përpilimi i grafikëve sipas të dhënave;</p> <p>-përgatitja e punës për prezantim;</p> <p>-prezantimi i punës dhe diskutim</p>

4.

TEMA 2: VEÇORITË NATYRORE TË VENDLINDJES			
synime	përmbajtje	terma	Aktivitete dhe metoda
<p>Nxënësi/nxënësjja:</p> <p>- të njihet me veçoritë natyrore të vendlindjes;</p> <p>-t'i dalloj dhe t'i shpjegoj termat: pasuri natyrore dhe raritete, liqen, burim, burim gjeotermal, lum, ujëvarë, baltë, bimësi e rrallë (lloji, ose pyll, kullotë, lëndinë), kafshë të rralla (lloji), pasuri minerale;</p> <p>-të nxitet të zhvilloj interes për veçoritë natyrore të vendlindjes.</p>	<p>Raritete natyrore, lokalitete dhe veçori të vendlindjes</p> <p>Propozim-projekte:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Hulumtimi i një rariteti/ lokaliteti natyror në vendlindje 2. Hulumtimi i bimëve të rralla në vendlindje 3. Hulumtimi i kafshëve të rralla në vendlindje 4. Projekt tjetër sipas dëshirës të nxënësve 	<p>Pasuri natyrore</p> <p>Raritete natyrore</p> <p>Burime - burime gjeotermale</p> <p>Ujëvarë</p> <p>Liqen</p> <p>Burim-lum</p> <p>Ujëvarë</p> <p>Baltë</p> <p>Bimë të rralla</p> <p>Kafshë të rralla</p>	<p>Hulumtimi i pasurive ose rariteteve natyrore, liqen, burim, burim gjeotermal, lum, ujëvarë, baltë, bimësi e rrallë (lloji, ose pyll, kullotë, lëndinë), kafshë të rralla (lloji), pasuri minerale - minierë</p> <p>Aktivitete:</p> <ul style="list-style-type: none"> -përpilimi i planit të hulumtimit (qëllime, detyra, afate); -vizita e një lokaliteti ku ndodhet objekti i hulumtuar; -bisedë me njerëz: banorë dhe ekspertë të atij lokaliteti; -shënimi i të dhënave të marra në hartën e lokalitetit, -përcaktimi i vendit të hulumtimit (zgjedhja e lokaliteteve), i mënyrave të evidentimit të të dhënave me shenja me të cilat do të shënohen objektet si dhe gjendja e tyre, në hartë, futja e të dhënave në tabelë; dhe/ose tabelë të përgatitur që më parë. -ndjekja dhe analiza e të dhënave dhe përpilimi i grafikëve; -përgatitja e punës për prezantim; - prezantimi i punës dhe diskutim

TEMA 3: TURIZMI, ÇLODHJA DHE REKREACIONI NË VENDLINDJE			
synime	përmbajtje	terma	Aktivitete dhe metoda
<p>Nxënësi/nxënësjja:</p> <p>- të njihet me kapacitetet e turizmit, çlodhjes dhe rekreacionit në vendlindje;</p> <p>-t'i dalloj dhe t'i shpjegoj objektet me të afërta turistike, lokalitetet për çlodhje dhe rekreacion;</p> <p>-t'i dalloj dhe t'i përmend lokalitetet e mundshme për turizëm rural;</p> <p>-ta kuptoj rëndësinë e turizmit për zhvillimin e bashkësisë lokale në vendlindje.</p>	<p>Objekte turistike në vendlindje</p> <p>Lokalitetet për çlodhje dhe rekreacion</p> <p>Mundësi për zhvillim të turizmit rural</p> <p>Propozim-projekte:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Hulumtimi i objekteve turistike në vendlindje 2. Hulumtimi i lokaliteteve për çlodhje dhe rekreacion 3. Hulumtimi i mundësive për turizëm rural 4. Projekt tjetër sipas dëshirës të nxënësave 	<p>Objekte turistike</p> <p>Lokalitet për çlodhje dhe rekreacion</p> <p>Turizmi rural</p>	<p>Hulumtimi i objektit/ lokalitetit (terrenit) më të afërt turistik për çlodhje dhe rekreacion / fshat me veçori tërheqëse për turizëm rural.</p> <p>Aktivitete:</p> <ul style="list-style-type: none"> -përpilimi i planit të hulumtimit (qëllime, detyra, afate); -vizita e një lokaliteti ku ndodhet objekti i hulumtuar; -bisedë me njerëz: banorë dhe ekspertë të atij lokaliteti; -shënimi i të dhënave të marra në hartën e lokalitetit, futja e të dhënave në tabelë; -ndjekja dhe analiza e të dhënave dhe përpilimi i grafikëve; -përgatitja e punës për prezantim; - prezantimi i punës dhe diskutim

TEMA 4: EKONOMIA NË VENDLINDJE			
synime	përmbajtje	terma	Aktivitete dhe metoda
<p>Nxënësi/nxënësjja:</p> <p>- të njihet me degët e ekonomisë në vendlindje;</p> <p>-t'i dalloj dhe t'i shpjegoj termat: fabrikë/ repart për prodhim, ndërmarrje tregtare/ dyqan, ekonomi bujqësore (vreshta, ara, frutikulturë, ara të mbjella me perime), fermë (për gjellë, për dele, dhi, pula etj.);</p> <p>-ta shpjegoj gjendjen/dobinë ekonomike e punës të objektit për bashkësinë lokale.</p>	<p>Objekte ekonomike në vendlindje</p> <p>Propozim-projekte:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Objekte industriale në vendlindje 2. Ekonomi bujqësore 3. Fermë në vendlindje 4. Projekt tjetër sipas dëshirës të nxënëseve 	<p>Fabrikë</p> <p>Repart</p> <p>prodhues</p> <p>Ekonomi bujqësore</p> <p>Fermë</p>	<p>Hulumtimi i fabrikës/ repartit për prodhim ose të ndërmarrjes tregtare/ dyqanit ose të ekonomisë bujqësore (vreshta, ara, frutikulturë, ara të mbjella me perime), fermë (për gjellë, për dele, dhi, pula etj.).</p> <p>Aktivitete:</p> <ul style="list-style-type: none"> -përpilimi i planit të hulumtimit (qëllime, detyra, afate); -vizita e objektit të zgjedhur për hulumtim; -bisedë punëtorët për punën e objektit; -shënimi i të dhënave të marra dhe futja e tyre në tabelë; -ndjekja e të dhënave dhe përpilimi i grafikëve; -analiza e të dhënave, përfundim -përgatitja e punës për prezantim; - prezantimi i punës

TEMA 5: NGJARJET KULTURORE NË VENDLINDJE			
synime	përmbajtje	terma	Aktivitete dhe metoda
<p>Nxënësi/nxënësja:</p> <p>- të njihet me karakteristikat dhe veçoritë kulturore të vendlindjes;</p> <p>-ta di rëndësinë e ngjarjeve kulturore në bashkësinë lokale (ekspozitë, ekspozitë muzeore, pjesë teatrale, promovim libri, kënge, ngjarje muzikore etj.)</p> <p>-të njihet me procedurat për organizimin e një ngjarjeje kulturore;</p> <p>-ta kuptoj dhe të vlerësoj zhvillimin e bashkësisë lokale nëpërmjet veçorive të ngjarjeve kulturore në të;</p> <p>-të nxitet të ketë sjellje korrekte para, gjatë dhe mbas mbajtjes të ngjarjes kulturore;</p> <p>Të aftësohet të jap mendimin e vet për ngjarjen para dhe mbas vizitës.</p>	<p>Ngjarje kulturore në vendlindje</p> <p>Propozim-projekte:</p> <p>1. Si të nxitet jeta kulturore në vendlindjen time</p> <p>2. veçoritë kulturore të bashkësive të ndryshme etnike në vendlindjen time</p> <p>3. Projekt tjetër sipas dëshirës të nxënësve</p>	<p>Ngjarje kulturore</p> <p>Ekspozitë</p> <p>Ekspozitë muzeore</p> <p>Teatër</p> <p>Promovim libri,</p> <p>Ngjarje muzikore</p>	<p>Vizitë dhe hulumtimi i ngjarjeve kulturore në vendlindje gjatë një periudhe (ekspozitë, ekspozitë muzeore, pjesë teatrale (dramë, opera, balet), film, festival, promovim libri ose kënge, ngjarje muzikore etj.)</p> <p>Aktivitete:</p> <p>-Zgjedhje, theksimi i synimeve dhe emri i ngjarjes kulturore që do të vizitohet;</p> <p>-përpilimi i planit të vizitës (grupet synuese, detyra, mënyra e punës, afate);</p> <p>-përgatitja për vizitë (biseda për mënyrën e duhur të sjelljes të çdo nxënësi para, gjatë dhe mbas ngjarjes);</p> <p>-bisedë me organizatorët dhe pjesëmarrësit në ngjarje;</p> <p>-ndjekja e ngjarjes dhe nxjerrja e përshtypjeve dhe përvojave;</p> <p>-diskutim për ngjarjen (për organizimin, për rëndësinë e tij për bashkësinë lokale dhe për çdo nxënës, për përvojën që mund të zbatohet, për ndjenjat dhe përshtypjet personale nga ngjarja).</p>

TEMA 6: BASHKËPUNIMI ME BASHKËSINË LOKALE			
synime	përmbajtje	terma	Aktivitete dhe metoda
<p>Nxënësi/nxënësjja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të njihet me mënyrën e organizimit të komunës të cilës i përket shkolla; -të njihet me simbolet e komunës (stemën, flamurin etj.) -të njihet me institucione, shoqata të veçanta lokale, me personalitete të rëndësishëm, me media; - të njihet me mënyrat dhe procedurat për bashkëpunim me pushtetin lokal, me shoqata, organizata, mediume lokale. -të nxitet të bashkëpunoj me - të njihet me pushtetin lokal, me shoqata, organizata, mediume lokale; 	<p>Organizimi i komunës</p> <p>Simbole të komunës</p> <p>Institucione, organizata dhe shoqata në komunë</p> <p>Propozim-projekte:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Bashkëpunim me komunën gjatë aksioneve të përbashkëta 2. Bashkëpunim me mediat lokale 3. Bashkëpunim me shoqata qytetarësh 	<p>Pushteti vendos</p> <p>Bashkësia lokale</p> <p>Media lokale</p> <p>Shoqata qytetarësh</p>	<p>Bashkëpunim me bashkësinë lokale (pushtetin vendos, bashkësinë lokale (shkollë tjetër, stacion policie, ambulancë), me ekspert, media lokale: gazetë, radio dhe stacion TV, shoqatë qytetarësh).</p> <p>Aktivitete:</p> <ul style="list-style-type: none"> -përgatitje: përpilimi i një plani për bashkëpunim, nëpërmjet përcaktimit të nevojave, synimeve dhe emërimit të bashkëpunimit dhe efektet e parashikuara; -Zgjedhja e institucionit dhe/ose ekspertit nga bashkësia lokale; -forma bashkëpunimi: biseda, marrëveshje, aktivitete/aksione të përbashkëta; -zgjedhja e vendit, kohës, afateve për bashkëpunim, detyra të nxënësve; -përgatitje teknike (listë e pjesëmarrësve në bashkëpunim); <p>Realizimi i bashkëpunimit të planifikuar (manifestimi).</p>

4. REKOMANDIME DIDAKTIKE

Në programin mësimor kërkohet mësimi të planifikohet sipas temave dhe hulumtimeve/projekteve mësimore. Mësuesit dhe nxënësit duhet t'i zgjedhin bashkarish hulumtimet/ projektet që do t'i realizojnë (4-6 projekte gjatë nja viti shkollor), sipas kushteve të punës, sipas dinamikës të realizimit, si dhe sipas nevojave dhe afiniteteve të nxënësve. Mësuesi e planifikon vetë fondit e orëve për realizimin e plotë dhe të suksesshëm të qëllimeve të vendosura nga programi. Mbas mbarimit të çdo hulumtimi, nxënësit duhet të diskutojnë për procedurat gjatë hulumtimit dhe të japin idetë e tyre për hulumtime të reja.

Rekomandohet përdorimi i mjeteve të mëposhtme mësimore:

- literaturë udhëzuese për kuadrin mësimor;
- burime të tjera mësimi – objekte dhe dukuri në natyrë;
- enciklopedi, atlase etj.;
- internet, softuerë arsimor;
- revista;
- mjete audio-vizuale dhe mjete të tjera.

5 VLERËSIMI I ARRITJEVE TË NXËNËSVE

Gjatë mësimit ndiqen dhe vlerësohen rregullisht arritjet e nxënësve, mblidhjen tregues për aktivitetet e tyre, motivimi për mësim, bashkëpunimi me të tjerët, pjesëmarrje në të gjitha fazat e hulumtimit, iniciativa, etj. (vlerësim formativ). Gjithashtu, çdo nxënës dhe prindërit e tij informohet rregullisht për ecurinë e nxënësit. Ky komponent është pjesë përbërëse e planifikimit të mësuesit për mësimdhënien dhe mësimin.

Nxënësit vlerësohen me notë.

6 KUSHTE E AMBIENTIT PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT MËSIMOR

Programi në lidhje me kushtet e ambienteve bazohet në Normativën për ambient, pajisje dhe mjete mësimore për shkollën fillore nëntëvjeçare, të miratuar nga ministri i arsimit dhe shkencës me Vendim nr. 07-1830/1 të datës 28.02.2008.

7 NORMATIVA PËR KUADROT MËSIMDHËNËS

Programin për hulumtimin e vendlindjes mund ta realizoj person që ka përfunduar arsim të lartë:

- në degën mësues histori-gjeografie, biologji-kimie;
- dhe degën –mësues historie; gjeografie; biologjie.

8 REZULTATET E PRITURA

Nxënësi / nxënësjja:

- I di objektet kulturore-historike në vendlindjen e vet;
- I di dhe i shpjegon termat: Objekt antik, përmendore, veçori etnologjike, shtëpi karakteristike; pasuri dhe raritete natyrore, bimë dhe kafshë të rralla, minerale; objekte turistike, lokalitete për çlodhje dhe rekreacion, turizëm rural; fabrikë/ repart prodhimi, ndërmarrje tregtare, ekonomi bujqësore, fermë; ngjarje kulturore në bashkësinë lokale, bashkëpunim me bashkësinë lokale
- I di frazat e hulumtimit (përzgjedhja e temës, vendosja e synimeve, bërja e planit të hulumtimit, veprimi) të një projekti të veçantë
- E kupton domethënien e lokalitetit dhe të objektit që e hulumton për zhvillim të bashkësisë lokale;
- Merr pjesë në përpilimin e planit të hulumtimit për objektin e zgjedhur për hulumtim;
- Përgatit tekst për rezultatet e hulumtimit nëpërmjet përpunimit dhe interpretimit të hartës, tabelës dhe grafikut;
- Di të përgatis dhe të kryej prezantim;
- Tregohet i ndjeshëm ndaj problemeve dhe nevojave të njerëzve të tjerë më të cilët komunikon;
- E di organizimin dhe karakteristikat të pushtetit lokal;
- I di veçoritë dhe ngjarjet kulturore të bashkësisë lokale;
- Di t'i prezantoj përshtypjet dhe përvojat e veta për ngjarjen/aktivitetet (me gojë dhe me shkrim);
- Di institucione dhe shoqata të bashkësisë lokale dhe procedurat e bashkëpunimit me ta.

9 KOMISIONI PËR PËRGATITJEN E PROGRAMIT MËSIMOR

1. Svetllana Brashnarska, këshilltar në BRO – Shkup, koordinator
2. Gordana Doneva – Atanasova, këshilltar në BRO – Shkup
3. D-r Sasho Panov, FFSHN – Instituti i biologjisë – Shkup
4. Sasho Serafimovski, SHF “Jan Amos Komenski” – Shkup
5. M-r Vllado Vellkovski, SHF “Shën Klimenti i Ohrit” – Shkup

10 VENDIM DHE DATA E MIRATIMIT TË PROGRAMIT MËSIMOR

Programin mësimor *hulumtimi i vendlindjes* për klasën e gjashtë të arsimit fillor tetëvjeçar, përkatësisht për klasën e shtatë, tetë ose të nëntë të arsimit fillor nëntëvjeçar e miratoi

Ministri

data _____